



**LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI**  
Albanian National Child Helpline (ANCH)

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;  
Tel / Fax: + 355 4 2265741  
E-mail: [alo116@crca.al](mailto:alo116@crca.al)      [www.alo116.al](http://www.alo116.al)



# SIGURIA E FËMIJËVE NË INTERNET NË SHQIPËRI

## RAPORT TEMATIK

JANAR – DHJETOR 2016

Shkurt, Tiranë 2017

## **PASQYRA E RAPORTIT**

- 1. HYRJE**
- 2. FAKTE DHE TË DHËNA**
- 3. MEDIAT SOCIALE DHE FËMIJËT**
  - **ASPEKTE POZITIVE TË PËRDORIMIT TË MEDIAS SOCIALE**
  - **ASPEKTE NEGATIVE TË PËRDORIMIT TË MEDIAS SOCIALE**
- 4. RREZIQET NDAJ TË CILAVE JANË EKSPOZUAR FËMIJËT /TË DHËNA NGA ALO 116 111 PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR2016**
- 5. PROFILI I FËMIJËVE QE RAPORTOJNË PRANË ALO 116 111**
  - **ÇFARË RAPORTOJNË FËMIJËT PRANË ALO 116 111**
- 6. ECURIA DHE REZULTATET E RASTEVE TË TRAJTUARA TEK ALO 116 PËR PERIUdhËN JANAR - DHJETOR2016**
- 7. PLATFORMA KOMBËTARE E INFORMACIONIT PËR SIGURINË E FËMIJËVE ONLINE**
- 8. ECURIA DHE REZULTATET E RASTEVE TË TRAJTUARA TEK PLATFORMA ISIGURT.AL**
- 9. HISTORI SUKSESI**
- 10.GJETJET E RAPORTIT**
- 11. REKOMANDIME**

## 1. HYRJE

Interneti, është mjaft tërheqës për fëmijët dhe të rinjtë të cilët gjithmonë e më shumë po njihen me botën virtuale, të mirat dhe mundësitë që ajo ofron. Ata janë më në kontakt të vazhdueshëm me internetin. Të gjithë jemi dëshmitarë se sa të aftë janë fëmijët tanë për të përdorur lojrat elektronike, telefonat celularë nga më të sofistikuarit, kompjuterat dhe paisje të tjera elektronike. Megjithatë, të rejat teknologjike, natyrisht, që kanë një kosto për familjet tona, kosto këto që shpesh herë nuk janë vetëm ekonomike.

Disa nga shërbimet që interneti ofron aktualisht janë kërkimet në internet të cilat të japin mundësi shfletimi në faqe të ndryshme nëpërmjet aplikacioneve kompjuterike të tilla si Posta Elektronike (E-mail), e cila mundëson dërgimin e mesazheve të tipit tekst, foto, muzikë, video nga një person te një tjetër; Bisedat Online (Chat Online) të cilat përdoren për të komunikuar në mënyrë të menjëhershme me personat që janë në linjë online; Rrjetet sociale (psh . Facebook, Twitter, Instagram, Snapchat ) ; Lojrat Online etj.

Zhvillimi i vullshëm i teknologjisë në vitet e fundit shoqërohet njëkohësisht edhe ekspozimin e fëmijëve ndaj risqeve të shfaqura si rrjedhojë e qëndrimit jo të sigurt të fëmijëve në internet. Për më tepër, jo rrallë ndodh që fëmijët të krijojnë varësi nga interneti ose ta përdorin atë pa njohuritë e duhura. Përgjithësisht, fëmijët dhe të rinjtë që përdorin internetin janë pothuajse autodidaktë dhe shpesh iu mungon një kujdestar në lidhje me lundrimin në internet.<sup>1</sup> Prandaj siguria e fëmijëve në internet konsiderohet një sfidë e kohëve të sotme dhe ne si shoqëri duhet të marrim masa në mënyrë që fëmijët të jenë të sigurt gjatë lundrimit të tyre online. Fëmijët duhen mësuar se si dhe sa duhet ta përdorin internetin, duhen kontrolluar në një farë mënyre dhe duhet komunikuar me ta për rreziqet.

Për t'i mbrojtur fëmijët nga këto rreziqe që vijnë si rrjedhojë e përdorimit të internetit, nevojitet që ata të edukohen dhe të përgatiten që të vetë-ndërgjegjësohen për rrezikun e lundrimit të pakontrolluar në internet.

Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë, ALO 116111 ka në fokus mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve edhe në rastet kur të drejtat e tyre "shkelen" në internet. Nëpërmjet ALO 116 fëmijët kanë mundësi që të raportojnë shqetësimet e tyre të përditshme. Nga këto raportime fëmijët tregojë historitë e tyre lidhur me rreziqet që kanë hasur gjatë lundrimit të tyre online. ALO 116 111- Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë mundëson që fëmijët të

---

<sup>1</sup> <http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/femijet%20dhe%20media%20shqip%20per%20shtyp.pdf>



**LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI**  
**Albanian National Child Helpline (ANCH)**

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;  
Tel / Fax: + 355 4 2265741  
E-mail: [alo116@crca.al](mailto:alo116@crca.al) [www.alo116.al](http://www.alo116.al)



cilët kontaktojnë shërbimin për të raportuar problematikat e tyre lidhur me sigurinë në internet dhe për të marrë më pas informacionin dhe asistencën e nevojshme psikologjike nga operatorët këshillues.

Ky Raport Tematik bëhet publik edhe në kuadër të Ditës Ndërkombëtare të Internetit të Sigurtë. Dita e Internetit të Sigurtë organizohet çdo vit në muajin shkurt për të nxitur përdorimin e përgjegjshëm dhe të sigurt të internetit dhe teknologjisë nga fëmijët dhe të rinjtë. Ky raport vjen si një tregues i rreziqeve që ndeshin fëmijët gjatë aktivitetit në internet por dhe për të nxitur një veprim gjithnjë e më të fuqishëm për të adresuar këto rreziqe. Më gjerësisht, në këtë raport do të gjeni disa nga format e shkeljes së të drejtave të fëmijëve online, rreziqet e mundshme me të cilat mund të përballen fëmijët gjatë lundrimit të tyre.

Disa nga fenomenet që do të trajtohen janë cyberbullying, grooming, pornografia, lojrat online, njohjet në rrjetet sociale, materiale ( video, tekste, komente, imazhe) me përmbajtje të papërshtatshme etj. Bashkangjitur do të prezantohen të dhëna të grumbulluara nga ALO 116111 bazuar në raportimet përgjatë gjashtë mujorit Janar – Dhjetor 2016.

## 2. TË DHËNA PËR PËRDORIMIN E INTERNETIT NË BOTË DHE NË SHQIPËRI

- ✓ Të dhënat nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikacionit (ITU), tregojnë se në vitin 2000 interneti përdorej vetëm nga 0,1% e popullsisë në botë, ndërkohë në vitin 2014 interneti përdorej nga 40% e popullsisë.
- ✓ Në fund të vitit 2014 në rang global, numëroheshin pothuajse 3 miliardë përdorues. 2/3 e përdoruesve të internetit janë nga vendet në zhvillim. Ndërkohë deri tani në 2016, një në dy individë në botë përdorin Internetin, rreth 47% e popullsisë së botës.
- ✓ Përsa i përket raportit meshkuj – femra, në të gjithë botën interneti përdoret me tepër nga meshkujt. <sup>2</sup>
- ✓ Në vitin 2015, 73.5 % e popullsisë së Europës ishin përdorues të internetit; Në Dhjetor të 2016, numri i përdoruesve të internetit në Europë u rregjistrua 73.9 %. <sup>3</sup>

- ✓ Sipas të dhënave të publikuara nga Internet World Stats, përdorimi i internetit në Shqipëri arriti në 60.1% të popullsisë në vitin 2014.
- ✓ 62.7 % e popullsisë në Shqipëri përdorë internetin gjatë vitit 2015. <sup>4</sup>

- ✓ Në dhjetor 2013 – janar 2014, 900 fëmijë të moshës 13 – 18 vjeçare, u intervistuan në Shqipëri nga World Vision, në lidhje me internetin.
- ✓ Sipas kësaj ankete 85% e të rinjve të anketuar kanë një kompjuter në shtëpi dhe

<sup>2</sup> <http://www.itu.int/>

<sup>3</sup> <http://www.internetworldstats.com/stats.htm>

<sup>4</sup> <http://www.internetworldstats.com/>

62% e fëmijëve që kanë akses në internet kanë një kompjuter në dhomën e tyre të gjumit. Ngacmimet (bullying), vjedhja e fjalëkalimeve, si dhe shikimi i paqëllimshëm i materialeve pornografike gjatë përdorimit të internetit janë çështje serioze me të cilat përballen fëmijët aktualisht, nga ku:

- 45% e të pyeturve vunë në dukje se fëmijëve i'u duhet të përballen me të tilla çështje çdo ditë.
- 44% të të pyeturve, fëmijët shohin materiale pornografike çdo ditë.
- 47% e fëmijëve të intervistuar pranojnë që, brenda vitit të fundit, ata janë kontaktuar online nga një individ i panjohur.<sup>5</sup>

- ✓ Sipas një ankete të zhvilluar në vitin 2011 nga UNICEF dhe Instituti Shqiptar i Medias, më shumë se 3/5 e të anketuarve thanë se e përdornin internetin disa herë në ditë, ndërkohë që 1/5 thanë se e përdorin një herë në ditë. Ndërkohë, vetëm 6 persona thanë se nuk e përdorin internetin. Shumica prej tyre e përdor në shtëpi por gjysma e tyre e përdor edhe në celular. Sipas këtij studimi fëmijët dhe të rinjtë që përdorin internetin janë pothuajse autodidaktë dhe shpesh iu mungon një kujdestar në lidhje me lundrimin në internet.<sup>6</sup>

<sup>5</sup> <http://www.wvi.org/sites/default/files/10-02-2015-Flet%C3%AB-Faktesh-WV-v2-b.pdf>

<sup>6</sup> <http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/femijet%20dhe%20media%20shqip%20per%20shtyp.pdf>

### 3. MEDIAT SOCIALE DHE FËMIJËT

Përdorimi i faqeve të medias sociale sot konsiderohet një ndër aktivitetet më të zakonshme të fëmijëve dhe të adoleshentëve. Çdo faqe online që lejon ndërveprim social konsiderohet si media sociale. Media të tilla iu mundësojnë fëmijëve dhe adoleshenteve mundësi për argëtim dhe komunikim. Punonjësit që punojnë me mirëqënien e fëmijëve janë në një pozitë unike për të inkurajuar përdorimin e shëndetshëm të mediave sociale dhe të monitorojnë dhe ndihmojnë fëmijët për kapërcimin e problemeve që ndeshin gjatë lundrimit online. Angazhimi në forma të ndryshme në mediat sociale është një aktivitet rutinë që sjell përfitim tek fëmijët dhe adoleshentët në përmirësimin e komunikimit, lidhjeve shoqërore madje edhe rritjen e aftësive. Faqet e mediave sociale si Facebook dhe MySpace ofrojnë mundësi të shumta të përditshme për lidhjen me miqtë, shokët e klasës, dhe njerëzit me interesa të përbashkëta.

Gjatë 5 viteve të fundit, numri i paradoleshentët dhe adoleshentëve që përdorin faqet e tilla është rritur në mënyrë drastike. Sipas Akademisë Amerikane të Pediatrie, 22% e adoleshentëve vizitojnë faqen e tyre të preferuar të mediave sociale më shumë se 10 herë në ditë, dhe më shumë se gjysma e adoleshentëve vizitojnë një media sociale më shumë se një herë në ditë. Kështu, një pjesë e madhe e zhvillimit social dhe emocional e kësaj gjeneratë ndodh në internet dhe në telefonat celularë. Për shkak të kapacitetit të tyre të kufizuar për vetë-rregullim dhe ndjeshmërisë ndaj presionit të bashkëmoshatarëve, fëmijët dhe adoleshentët mund të gjenden në rrezik gjatë lundrimit dhe të eksperimentimit në mediat sociale. Përdorimi me intensitet të lartë i medias sociale i ekspozon të fëmijët ndaj disa sjelljeve si: cyberbulling, sexting, ekspozimi ndaj përmbajtjeve të papërshtatshme, privatësia, diskriminimi, grooming etj. Problem tjetër është nga interneti.<sup>7</sup>

Faqet e mediave sociale lejojnë adoleshentët të përbushin disa interesa si qëndrimi i lidhur me miqtë, familjen, njohja me miq të rinj, ndarjen e fotove, shkëmbimin e ideve etj. Pjesmarrja në rrjetet sociale gjithashtu mund t'ju ofrojë adoleshentëve përfitime edhe më të thella si rritjen e kreativitetit individual dhe kolektiv përmes zhvillimit dhe ndarjeve të përbashkëta të përpjekjeve artistike, rritjen e kapaciteteve nëpërmjet krijimit të blogjeve etj.

---

<sup>7</sup> <http://pediatrics.aappublications.org/content/127/4/800>

#### **ASPEKTE POZITIVE TË PËRDORIMIT TË MEDIAVE SOCIALE:**

- Media sociale lehtëson zhvillimin e ekspertizës teknike dhe të kuptuarit praktik të teknologjisë nga fëmijët;
- Ndhmon fëmijët të mbajnë kontakte intensive me të afërmit dhe miqtë;
- Ndhmon në zhvillimin e prespektivave për çështje të ndryshme;
- Mësojnë gjëra të reja dhe shkëmbejnë ide;
- Motivon fëmijët të bëhën e pjesë e diskutimeve të ndryshme dhe inkurajon lirinë e të shprehurit;

#### **ASPEKTE NEGATIVE TË PËRDORIMIT TË MEDIAVE SOCIALE:**

- Media sociale nuk siguron kontroll të mjaftueshëm të informacionit. Duke lundruar në median sociale fëmijët mund të ndeshen me faqe interneti të cilat në përmbajtjen e tyre mund të kenë informacion të papërshtatshëm dhe të paligjshëm, informacione të cilat mund të ndikojnë negativisht në procesin e tyre të të menduarit;
- Cyberbulling është një tendencë tjetër që fëmijët mund të ndeshen në median sociale. Cyberbulling ka efekte të rrezikshme dhe ndonjëhere fatale. Ky fenomen shkakton shumë viktima çdo vit;
- Humbje kohe. Duke shpenzuar shumë kohe ne median sociale mund të ndikojë negativisht duke interferuar me aktivitetin e përditshëm të fëmijëve. Varësia mund të manifestoje në vetvete një sërë simptomash që mund të ndikojnë në shëndetin fizik të fëmijëve; Qëndrimi i tejzgatur mund të sjellë problematika në marrëdhëniet ndërpersonale të fëmijës, ndikim negativ në marrëdhëniet familjare, prishje e raporeve me shoqërinë, zbehje të jetës sociale- kulturore; rënie nga mësimet, kohë e pamjaftueshme për të përgatitur detyrat e shtëpisë; probleme dhe efekte negative shëndetësore, probleme pagjumësie;
- Përdorimi i medias sociale kryesisht gjatë natës ka një impakt të rëndësishëm në aspektin emocional dhe në cilësinë e gjumit duke e lidhur atë më nivele të larta të ankthit;



#### **4. RREZIQET NDAJ TË CILAVE JANË TË EKSPOZUAR FËMIJËT NË INTERNET: TË DHËNA NGA ALO 116 111 JANAR-DHJETOR 2016**

Përpos lehtësirave dhe avantazheve që Interneti ofron, duhet thënë që duke pasur parasysh që janë miliona njerëz që përdorin internetin, atëherë edhe numri i keqpërdoruesve është i madh. Përdorimi i internetit nga fëmijët është rritur dhe në këtë aspekt fëmijët janë gjithmonë e më shumë të ekspozuar ndaj rreziqeve online. Nisur nga kjo, fëmijët kanë treguar historitë e tyre lidhur me rreziqet që kanë hasur gjatë lundrimit online duke kërkuar ndihmën e ALO 116 111- Linjës Kombëtare të Këshillimit për Fëmijë.

Bazuar në të dhënat e mbledhura nëpërmjet ALO 116 111 dhe rasteve të regjistruara, numri i telefonata, në lidhje me sigurinë në internet ka qënë i konsiderueshëm. Që prej 6 mujorit të fundit, vihet re rritje e ndjeshme e rasteve të trajtuara lidhur me sigurinë në internet, kjo si rrjedhojë e ndikimit që ka pasur fushata informuese dhe edukuese për internetin e sigurt dhe Platforma Kombëtare mbi Sigurinë Online -iSIGURT.AL

Grupmosha që ka telefonuar më shpesh kanë qënë nga 10 – 15 vjeç. Raportimet më të shumta kanë qënë lidhur me lundrimin e pasigurt në internet. Për sa i përket shtrirjes gjeografike, Tirana, Elbasani, Lezha, Kuçova, Gjirokastra, Vlora janë qytetet nga të cilat vijnë pjesa më e madhe e raportimeve mbi pasiguritë online.

##### **1. Telefonatat informuese për Internetin e Sigurt**

Nisur nga të dhënat e raportuara pranë ALO 116 gjatë periudhës Janar –Dhjetor 2016 mund të themi se fëmijët kanë telefonuar pranë shërbimit për t'u pajisur me paketat bazë informuese mbi internetin e sigurt dhe si mund të mbrohen kur u ndodh diçka shqetësuese në internet. Fëmijët kanë kërkuar informacion mbi pasiguritë, rrisqet ndaj të cilave ekspozohen fëmijët, përdorimin e rrjeteve sociale, lojrave online, njohjeve në rrjetet sociale dhe kanë kërkuar këshilla dhe rekomandime se si mund të ishin më të mbrojtur gjatë lundrimit të tyre në internet.

\*Periudha Janar – Dhjetor 2016

Kategoria	Nr. i telefonatave	Gjinia F/M	Grupmosha
Informacion mbi Internetin e Sigurt.	818	488/330	8-14 vjeç

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2016 janë pritur 485 telefonata të fëmijëve dhe adoleshentëve të cilët kanë zgjedhur ALO 116 111 si një burim të sigurt për të marrë informacionin për të cilin ata kanë nevojë. Fëmijët përgjithësisht kanë kërkuar informacion mbi internetin, rrjetet sociale, pasiguritë gjatë lundrimit në internet, si mund të bëjnë raportim apo bllokim të një faqeje/personi, si mund të ndryshojë fjalëkalimet e tyre, si mund të kenë një fjalëkalim më të sigurt etj.

Pjesa më e madhe këtyre telefonuesve kanë qënë djem dhe kryesisht të grupmoshës 8-14 vjeç. Rritja e numrin të telefonatave për t'u informuar mbi sigurinë online, përkon me fushatën ndërgjegjësuere që ALO 116 ka zhvilluar gjatë kësaj periudhe në disa shkolla 9-vjeçare.

ALO 116 që prej 2011 dhe në vazhdim e ka konsideruar aktivitetin e femijëve në internet si një çështje të rëndësishme me impakt në mirqënien e tyre fizike dhe psikologjike. Për këtë qëllim ka organizuar fushata intensive ndërgjegjësuere në të gjithë shkollat në nivel kombëtar për ndërgjegjësimin e femijëve, të rinjve, mësuesve dhe publikut të gjerë në lidhje me përdorimin e sigurt të internetit.

## 2. Problematikat e raportuara për çështje të sigurisë në Internet

Më poshtë janë listuar disa nga rreziqet më të hasura online sipas raportimeve të fëmijëve:


- Materiale me përmbajtje të papërshtatshme
- Materiale me përmbajtje pornografike
- Format e ndryshme të abuzimit psikologjik gjatë aktivitetit online të fëmijëve (Cyberbullying)
- Lojrat Online
- Viruset dhe spam-et
- Njohjet me njerzit e panjohur

- Shtytja e femijës për të kryer marrëdhënie seksuale (Grooming)
- Sms me përmbajtje të papërshtatshme (sexting)

Gjatë kësaj periudhe janë raportuar dhe trajtuar gjithsej 45 raste të lidhura me sigurinë online të fëmijëve.

## 2.1 Ndarja e rasteve sipas gjinisë së raportuesit


Grafiku i mëposhtëm pasqyron të dhëna mbi ndarjen gjinore të telefonuesve që kanë raportuar shqetësimet lidhur me internetin.



Siç vihet re nga Grafiku, shumica e fëmijëve kanë kërkuar ndihmën e ALO 116111 për të diskutuar mbi pasiguritë e tyre gjatë lundrimit online. Djemtë në raport me vajzat kanë qënë më të shumtë në numër.

## 2.2 Ndarja e rasteve sipas moshës së telefonuesëve.

Në këtë grafik pasqyrohen të dhënat në bazë të moshës së telefonuese të cilët kanë raportuar për shqetësime gjatë përdorimit të internetit.



Nga grafiku, vihet re se grupmosha 13-15 vjeç është ajo që telefonon më shumë për të raportuar shqetësime lidhur me çështje të sigurisë online, varësi nga rrjetet sociale ose

interneti, lojrat online apo për sms/postime me përmbajtje të papërshtatshme. Grupmosha që telefonon më shpesh për Cyber Bulling është ajo 16-17 vjeçare.

### 2.3 Çështje të Sigurisë së fëmijëve në internet

Materiale me përmbajtje të papërshtatshme

Jo të gjitha materialet që janë në internet janë të përshtatshme për të gjitha moshat. Përmbajtje e papërshtatshme i referohet çdo lloj materiali viziv, video apo audio në internet, i cili konsiderohet i papërshtatshëm për moshën e fëmijëve por që është në dispozicion të publikut. Kështu për shembull, pranë shërbimit të ALO 116 111 fëmijët kanë raportuar se në disa raste kanë parë materiale që kanë përmbajtje pornografike, me shfaqje dhune apo urrejtje. Fëmijët ende nuk janë të gatshëm për të parë këto informacione pasi në të kundërt mund të ndikojnë negativisht në zhvillimin e tyre.

- Shikimi apo kontakti me përmbajtje të tilla mund të trazojë botën e brendshme të fëmijëve. Në rastin e kontaktit të fëmijëve me materiale pornografike, mund të shtrembërojë zhvillimin psiko-social.
- Një përmbajtje e tillë mund të jetë e dhunshme, raciste apo fyese;
- Pa udhëzimet e duhura dhe pa filtra fëmijët mund të ndeshen aksidentalisht online me përmbajtje e cila për ata mund të shkaktojë stres dhe ankth.

Njohjet me njerëz të panjohur

Dhomat e chatit, rrjetet sociale apo faqe të ndryshme në internet ofrojnë mundësinë për krijimin e njohjeve të reja online. Si rrjedhojë fëmijët mund “të ndeshen” në internet me njerëz të cilët të fshehur pas profileve dhe identiteteve false, shfrytëzojnë situatat për të manipuluar dhe lënduar fëmijët në mënyra të ndryshme.


Viruset dhe Spam-et

Virusi është një program i vogël i cili është në gjendje të shumëzohet e të shpërndahet nëpër funksionet e caktuara të kompjuterit dhe ta bëjë atë që të mos funksionoj normalisht apo ta shkatërroj gjithë sistemin e eksplorimit .E-mailët e padëshiruara nga dërgues të panjohur që mund të përmbajnë viruse, adresa që të dërgojnë në faqe të infektuara me

viruse apo faqe me përmbajtje të papërshtatshme janë disa nga format kryesore nëpërmjet të cilave mund të shkarkohet.<sup>8</sup>

Spam i referohet mesazheve elektronike të padëshiruara që vijnë në postën elektronike. Zakonisht janë në formën e e-maileve të cilat mund të përmbajnë viruse apo materiale pornografike. Spam-et përbëjnë një shqetësim për këdo që ka një adresë e-maili.<sup>9</sup>

Grafiku i mëposhtëm paraqet të dhënat mbi Çështje të Sigurisë Online, Janar-Dhjetor 2016 në bazë të klasifikimit gjinor.



Për periudhën Janar-Dhjetor 2016, numërohen 46 raste të cilat raportojnë shqetësime gjatë lundrimit online, problematika që lidhen me komunikimet me pasiguritë e tyre kur janë online, kur kërkojnë një informacion, kur shohin një publikim apo faqe e cila përmban informacion të papërshtatshëm, kur në faqet e tyre në rrjetet sociale publikohen tekste/komente/imazhe/video me përmbajtje të papërshtatshme, mesazhe private që kanë përmbajtje pornografike ose të sikletshme etj.

Një pjesë e këtyrë fëmijëve kanë zgjedhur gjithashtu të raportojnë problematika të tilla edhe në platformën online **iSIGURT.al**. Pjesa më e madhe e raportuesëve janë të moshës 8-12 vjeç dhe shumica janë meshkuj. Përgjithësisht fëmijët kërkojnë ndihmë dhe zgjidhje të menjëhershme për shqetësimet që kanë pasur në internet, shpesh herë ndihen në siklet, mendojnë se imazhi i tyre është duke u dëmtuar dhe kjo si rrjedhojë ndikon tek gjendia e tyre psiko-emocionale. Në pjesën më të madhe të rasteve prirjen të përballen vetëm, duke mos dashur të venë në djeni askënd, aq më tepër familjet e tyre.

<sup>8</sup> [https://sq.wikipedia.org/wiki/Virusi\\_i\\_kompjuterit](https://sq.wikipedia.org/wiki/Virusi_i_kompjuterit)


<sup>9</sup> <https://sq.wikipedia.org/wiki/Spam>

Këshilluesit kanë ofruar ndihmë dhe mbështetje psikologjike për problematikat që kanë raportuar, referim, psikoedukim për rreziqet gjatë lundrimin online, pasiguritë në rrjetet sociale dhe orientim për një lundrim sa më të sigurt online. Në këtë mënyrë, fëmijët janë pajisur me një paketë informacioni të nevojshëm për të lundruar të sigurt gjatë kohës që janë online dhe se si mund të veprojnë në rast se janë dëshmitarë apo viktimë e një forme të shkeljes së të drejtave të tyre në internet.

#### 2.4 Abuzimi psikologjik gjatë aktivitetit në internet (Cyberbullying)

Cyberbullying përdoret për t'iu referuar situatës kur një fëmijë apo adoleshentë është kërcënuar, keqtrajtuar, poshtëruar, tallur, ofenduar ose është vënë në shënjestër në mënyrë të qëllimshme nga një fëmijë ose adoleshent tjetër duke shfrytëzuar përdorimin e internetit ose telefonat celularë.<sup>10</sup>

Ditët e sotme mundesia për të aksesuar internetin nëpërmjet aparateve smart phone kontribuon shpesh herë që bullying të mos mbetet vetëm brenda kufijve të klasës apo të oborit të shkollës. Kështu, video, imazhe, tekste dhe mesazhe me përmbajtje të dëmshme apo të papërshtatshme shpërndahen lehtësisht në internet duke ndikuar seriozisht në probleme psikosociale dhe të shëndeteti mendor.



Disa nga format e cyberbullying që fëmijët kanë raportuar pranë ALO 116 111 janë :

- ✓ Postim i fotografive, videove të personave të tjerë pa miratimin e tyre, me qëllim tallës dhe fyes;
- ✓ Krijimi i profileve fallse në rrjetet sociale në emër të një individi tjetër me qëllim dëmtimin e reputacionit të tij/saj.
- ✓ E-maile, mesazhe, tekste fyese, tallëse, paragjykuese, kërcënuese etj;

Janë raportuar 14 raste të cyberbullying, fëmijë të fyer ose të ofenduar nga persona të njohur/panjohur nëpërmjet përdorimit të adresave jo-reale në rrjetet sociale duke keq

<sup>10</sup> <http://cyberbullying.org/what-is-cyberbullying>

përdorur identitetin e tyre, raste të shfrytëzimit të fotove personale, të publikuara të shoqëruara me etiketime dhe fjalë ofenduese apo fyese.

Përsa i përket klasifikimit gjinor ka më tepër vajza që raportojnë raste të cyber bullying. Grupmosha e tyre varjon nga 13-17 vjeç.

## 2.5 Ekspozimi me materiale Pornografike.

Fëmijët kalojnë shumë kohë në internet duke parë materiale të ndryshme të cilat mund t'i shërbejnë për tu argëtuar apo për të plotësuar detyrat e tyre. Shumë nga këto materiale mund të jenë nevojshme për fëmijët ndërsa disa të tjera jo. Ata mund të përballen çdo ditë me materiale pornografike të shfaqura edhe në faqe të zakonshme ku mund të lundrojnë fëmijët. Sipas 44% të të pyeturve në studimin e World Vision në vitin 2013, fëmijët shohin materiale pornografike çdo ditë.<sup>11</sup>

Fëmijët janë të ekspozuar ndaj materialeve pornografike të paqëllimshme që në të shumtën e kohës ndodh në qendra internet. Kjo ndikon negativisht në perceptimin e fëmijëve dhe mënyrën e tyre të të menduarit. Pornografi konsiderohen të gjitha materialet seksuale që kanë për qëllim kryesor të nxisin seksualisht shikuesin, dëgjuesin apo lexuesin.

Bazuar në konstatimet e ALO 116 111 gjatë raportimeve lidhur me çështjet e sigurisë në internet, fëmijët në disa raste kur kanë qënë në shoqërinë e bashkëmohatarëve të tyre kanë hapur faqe me përmbajtje pornografike. Kështu, për t'iu shmangur kontrollit prindëror shpesh herë zgjedhin që këto materiale t'i shohin nëpërmjet aparateve smart phonë apo në qendrat e internetit.<sup>12</sup>

---

<sup>11</sup> <http://www.wvi.org/sites/default/files/Internet%20Safety%20OK.pdf>

<sup>12</sup> [http://www.ecpat.org/wp-content/uploads/legacy/SECO%20Manifestations\\_CSAM.pdf](http://www.ecpat.org/wp-content/uploads/legacy/SECO%20Manifestations_CSAM.pdf)



## 2.6 Lojërat Online

Interneti sot mundëson faqe të ndryshme të cilat ofrojnë argëtim nëpërmjet lojrave të tyre kompjuterike. Ju mund të luani me kompjuter, telefona celulare në rrjete sociale etj.

*Nëse luani lojëra në internet, jeni të ekspozuar ndaj disa rreziqeve:*

- Ka persona të rritur, që përfshihen në lojë bashkë ju. Ata shpesh herë ata shtiren se janë fëmijë për të krijuar shoqëri. Por qëllimi i tyre mund të mos jetë i mirë. Ata mund të duan të fitojnë besimin tuaj me qëllim që mund t'iu bëjnë keq më vonë.
- Gjatë lojës shpeshherë shfaqen (faqe interneti të cilat hapen vetë) në ekranin tuaj. Përgjithësisht janë reklama, por mund të këtë edhe faqe me përmbajtje të papërshtatshme. Hapja e tyre automatikisht rezikon kompjuterin që po përdorni duke qënë se ato mund të jenë burim virusesh të cilat dëmtojnë gjendjen e tij.

## 2.7 Shtytja e femijës për të kryer marrëdhënie seksuale (Grooming)

Grooming- është përgatitja dhe manipulimi psikologjik i një fëmije me qëllim shfrytëzimin seksual.

Karakteristikat e një abuzuesi (groomer) janë:

- Fiton besimin e fëmijës;
- Ndërton komunikim të vazhdueshëm me fëmijën;
- E shtyn fëmijën të zhvillojnë komunikim në kontekst privat, nëpërmjet programeve “messenger”, “dhoma chati” etj;
- Një groomer mund të manipulojë të dhënat e tij në rrjetet sociale, për të krijuar më lehtë marrëdhëniet me fëmijët;
- Qëllimi i një groomer është që të rregullojë një takim me fëmijën ose ta manipulojë atë me qëllim përdorimin e tij për pornografi;
- Priret të dërgojë foto, video apo linqe pornografike tek fëmijët;
- Ka tendencë të zhvillojë biseda të papërshtatshme për moshën e fëmijëve;
- Kërkon që fëmija të ndajë imazhe personale dhe intime .

Grooming shkakton lëndim psikologjik të fëmijës për shkak të manipulimit dhe joshjes që groomeri përdor. Grooming krijon një model të dëmshëm të marrëdhënieve të fëmijëve me

të rriturit. Për këtë arsye grooming është diçka që kërkon vëmendje dhe reagim të menjëhershëm.<sup>13</sup>

ALO 116 për këtë periudhë raporton se nuk është identifikuar asnjë rast me këtë problematikë.

## **2.8 Sms dhe Postime me përmbajtje të papërshtatshme (Sexting)**

**Sexting** - është përdorur për të përshkruar dërgimin e fotove, mesazheve me përmbajtje seksuale kryesisht nëpërmjet telefonit. Ndonëse dërgimi këtyre përmbajtjeve mund të ketë qënë fillimisht me miratimin e të dyja palëve, mund të ndodhë që këto përmbajtje të përfundojnë duke qarkulluar në internet kryesisht kur marrëdhëniet marrin fund.<sup>14</sup>

Pranë shërbimit të ALO 116 111 raportimet për SMS dhe postime me përmbajtje të papërshtatshme kanë qënë 2 telefonata për periudhën Janar-Dhjetor 2016. Një vajzë dhe një djalë të moshës 13 dhe 15 vjeç tregojnë se kanë marrë mesazhe me përmbajtje seksuale nga persona të pidentifikuar.

---

<sup>13</sup> [http://www.ecpat.org/wp-content/uploads/legacy/SECO%20Manifestations\\_Grooming.pdf](http://www.ecpat.org/wp-content/uploads/legacy/SECO%20Manifestations_Grooming.pdf)

<sup>14</sup> <http://www.saferinternet.org.uk/sites/default/files/Resources/So%20you%20got%20naked%20online.pdf>

## 5. PROFILI I FËMIJËVE QË RAPORTOJNË PROBLEMATIKA ONLINE

Interneti mundëson që fëmijë të grupmoshave të ndryshme ta përdorin për t'u informuar, për të bërë detyrat apo edhe për qëllim argëtimi, për të luajtur, për të dëgjuar muzikë, për të komunikuar me shoqërinë, etj. ALO 116 111 bazuar në punën e përditshme me fëmijët që i besojnë shërbimeve të saj për të marrë informacion apo për t'u këshilluar për shqetësimet e tyre në internet, ka konstatuar se preferencat e fëmijëve lidhur me aktivitetet që dëshirojnë të bëjnë në internet ndrshojnë në varësi të profilit të moshës në të cilën janë. Pjesa më e madhe fëmijëve që diskutojnë çështje të ndryshme të lidhura me sigurinë online varjojnë nga moshë 8-17 vjeç. Më poshtë janë paraqitur disa nga cilësitë që përshkruajnë në mënyrë të përgjithshme profilin e tyre.

### Fëmijë të moshës 8-12 vjeç

Fëmijët që në moshën 8 vjeçare përgjithësisht kanë shfaqur interes për të zbuluar më tepër rreth botës virtuale dhe veçanërisht për rrjetet sociale. Fëmijët tregojnë se faqet që përdorin më shpesh janë rrjetet sociale facebook, instagram, youtube dhe lojrat online. Ndërkohë për të kërkuar informacion për detyrat e shtëpisë fëmijët janë përgjithësisht të informuar nga mësuesit e tyre për burimet që duhet të shfrytëzojnë, wikipedia është burimi më i sigurt për ta. Pothuajse të gjithë fëmijët që kanë kontaktuar ALO 116, kanë pasur në përdorim minimalisht një adresë në një rrjet social. Një pjesë më e vogël kanë krijuar profilet e tyre edhe më shumë se dy rrjete sociale. Sipas tyre rrjeti social konsiderohet si një burim i nevojshëm komunikimi dhe argëtimi me shokët.

Fëmijët raportojnë pranë ALO 116 se shumicën e kohës që kalojnë në internet janë të pashoqëruar nga prindërit. Madje disa prej tyre, tregojnë se prindërit nuk dinë të përdorin shumë mirë kompjuterin. Të tjerë, tregojnë se për t'iu shmangur kontrollit prindëror në disa raste zgjedhin të përdorin aparatet e tyre personale apo të frekuentojnë qendrat e internetit. Ajo që konstatohet është se ata janë të informuar mbi përdorimin e internetit por nuk janë majftueshëm të vetëdijshëm për rreziqet online.

Por nga ana tjetër, gjatë procesit të këshillimit identifikohen raste kur fëmijët përgjithësisht ndihen të neglizhuar dhe "të lënë pas dore" nga familjarët apo miqtë e tyre. Përjetojnë ndienja vetmie, kërkojnë vazhdimisht vëmendje dhe si rrjedhojë zgjedhin rrjetet sociale si një mënyrë për të mbushur "boshllëkun" që përjetojnë.

## Fëmijë të moshës 13-17 vjeç

Fëmijët e kësaj moshe kanë dëshirë gjithmonë e në rritje për të qënë të lirë dhe të pavarur në aktivitetet që dëshirojnë të bëjnë. Si rrjedhojë është e vështirë edhe për prindërit që t'i mbikqyrin lundrimet apo komunikimet e tyre online. Disa adoleshentë tregojnë se kanë kuriozitetin për të hyrë në faqe të internetit që kanë material të papërshtatshëm.

Përgjithësisht në këtë moshë janë të aftë për të dalluar materialet me përmbajtje të papërshtatshme, informacionet komerciale, viruset e mundshm kompjuterike etj. Gjatë bashkëbisedimeve me këshilluesit, fëmijët e kësaj grupmoshe tregojnë se kanë aftësi të mira teknike në përdorimin e kompjuterave apo aparaturave të tjera. Aftësi që sipas tyre i tejkalojnë ato të prindërve. Nga ana tjetër në të shumtën e rasteve nuk flasin me prindërit për problematikën që hasin online. Preferojnë ta ndajnë me bashkëmoshatarët e tyre.

Pothuajse të gjithë fëmijët kanë raportuar se kanë profilin e tyre në rrjetet sociale. Fëmijët tregojnë se kanë tendencë të rritin kontaktet e tyre online, një pjesë e vogël kanë pranuar kërkesa miqësish edhe nga persona të panjohur. Ata tashmë janë të ndërgjegjshëm për reziqet e mundshme dhe pasiguritë gjatë lundrimit online, por megjithatë duket se një pjesë e tyre pavarësisht kësaj mendon se e kanë nën kontroll situatën. Tregojnë se përdorin herë pas here opsionet 'blllok' dhe 'raportoj' në rastet kur mendojnë se dikush po bezdis.

## Çfarë raportojnë fëmijët pranë Alo 116 111

Bazuar në punën e ALO 116111 në përvojën e saj 7 vjeçare, mund të themi se interesi i fëmijëve për t'u informuar apo për t'u këshilluar mbi çështje që lidhen me pasiguritë dhe abuzimet online ka pësuar rritje të ndjeshme vitet e fundit.

Fëmijët përgjithësisht kanë kontaktuar shërbimin e ALO 116 111 për tu pajisur me paketat bazë informuese mbi internetin e sigurt dhe si mund të mbrohen apo të veprojnë kur u ndodh diçka shqetësuese në internet. Të tjerë dëshirojnë të ndajnë emocionet dhe përjetimet e tyre psikologjike për situatën në të cilën ndodhen. Pra arsyet përse ata telefonojnë janë të ndryshme në varësi të moshës dhe nevojave që kanë.

Më poshtë janë listuar disa çështje për të cilat fëmijët raportojnë.

### Çfarë kanë raportuar fëmijët ?

Fëmijë 10-12 vjeç kanë treguar se në disa raste e kanë përdorur internetin për të kërkuar materiale të papërshtatshme për moshën e tyre.

Raste të vjedhjeve të faqeve të profilit në rrjete sociale dhe keqpërdorim të tyre.

Fyerje, ofendime, tallje nga persona të njohur/panjohur nëpërmjet përdorimit të adresave jo-reale në rrjetet sociale

Fëmijët kanë raportuar se janë kërcënuar nga persona të panjohur nëpërmjet sms-ve në facebook.

Fëmijët tregojnë që persona të panjohur iu dërgojnë ftesa për tu bërë shokë/shoqe në rrjetet sociale.

Fëmijët janë ankuar edhe për postime me përmbajtje të papërshtatshme që shokët ju kanë bërë në formë shakaje në profilin e tyre (video/foto/tekste).

Ata ankohen se persona të tjera kanë përdorur te dhënat e tyre (mosha, foto, emer mbiemer, adrese shkolle) për të hapur një faqe të paautorizuar pasi janë larguar nga një qendër interneti.

Fëmijët raportojnë se e përdorin internetin edhe për tu informuar për rezultatet e ndeshjeve të futbollit kryesisht përdorin faqet e basteve sportive duke qënë se ata shprehen se luajnë skedina.

Fëmijët shprehen se dëgjojnë shumë video muzikore në youtube, një pjesë e të cilave janë të paçensuruara me tekste vulgare dhe banale ku subjekti kryesor i teksteve të tyre janë dhuna dhe ofendimet ndaj njëri-tjetrit .

Ndërkohë gjatë përdorimit të lojrave online raportojnë se shpesh herë iu shfaqen pop-up, faqe komerciale apo faqe me përmbajtje të papërshtatshme për moshën e tyre.

## 6. ECURIA DHE REZULTATET E RASTEVE TË TRAJTUARA TEK ALO 116 PËR PERIU DHËN JANAR – DHJETOR 2016

Numri total i rasteve të trajtuara nga ALO 116, mbi sigurinë online për periudhën Janar – Dhjetor 2016 është 76.



**LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI**  
**Albanian National Child Helpline (ANCH)**

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;  
Tel / Fax: + 355 4 2265741  
E-mail: [alo116@crca.al](mailto:alo116@crca.al) [www.alo116.al](http://www.alo116.al)



Të gjitha rastet janë trajtuar nga këshilluesit e ALO 116 nëpërmjet :

- Psiko-edukimit të fëmijëve të cilët kanë qënë pjesë e incidenteve apo formave të ndryshme të shfrytëzimit online ;
- Informimit mbi rreziqet potenciale të përdorimit të internetit nga fëmijët pa programe filtrimi/kontrolli dhe pa limite kohore ;
- Informimit të prindërve mbi paketat informuese dhe filtruese të informacionit për fëmijët e tyre;
- Këshillimit psikologjik mbi emocionet, përjetimet, frikërat dhe pasiguritë që fëmijët kanë shprehur tek ALO 116 ;
- Bashkëpunimit me institucionet relevante për raportimin, denoncimin dhe mbylljen/fshirjen e materialeve të papërshtatshme dhe të paligjshme;
- Përpjekjeve për parandalimin e incidenteve/ngjarjeve online që mund të ndikojnë në mirëqënien fizike dhe emocinale të fëmijëve në aktivitetin e tyre online.

Falë marrëdhënies pozitive të ndërtuar me fëmijët, komunikimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit me institucionet mbështetëse, rastet rezultojnë të përfunduara. Rastet e bullizmit dhe cyber bullizmit janë trajtuar gjatë në kohë, nëpërmjet një komunikimi intensiv dhe profesional me këshilluesit.

## 7. RAPORTIME NË PLATFORMEN KOMBËTARE E INFORMACIONIT PËR SIGURINË E FËMIJËVE NË INTERNET


Platforma Kombëtare e Informacionit për Sigurinë e Fëmijëve Online – “[WWW.ISIGURT.AL](http://WWW.ISIGURT.AL)” është një platformë online e cila shërben si një burim unik informacioni në lidhje me internetin e sigurt për fëmijët. Kjo platformë ka prioritet të saj çështjet që kanë të bëjnë me aktivitetet e fëmijëve online, siç janë shkarkimi i materialeve, postimi, bisedat në ‘chat’, publikimi i të dhënave personale, cyberbulling, pornografinë online, përmbajtjet e papërshtatshme etj.

Platforma Kombëtare e Informacionit për Sigurinë e Fëmijëve Online është një qendër burimore dhe qasje ekspertësh dhe grupeve të interesit për të ofruar modelet më të mira për një internet të sigurt. Platforma shërben si një hapësirë informimi ku prindërit, mësuesit por edhe të gjitha ata që punojnë me/për fëmijët për të mbrojtur fëmijët nga abuzimi online. Pjesë shumë e rëndësishme e platformës për sigurinë online është seksioni RAPORTO, i cili pret dhe analizon ankesat nga fëmijët, prindërit, mësuesit, profesionistët që punojnë me/për fëmijët apo çdo person tjetër i interesuar për të raportuar abuzimet online dhe duke i referuar të gjitha ankesat pranë agjensive përkatëse të zbatimit të ligjit.

Raportimi i rasteve tek “[WWW.ISIGURT.AL](http://WWW.ISIGURT.AL)” është një proces i lidhur drejtpërdrejtë me ALO 116. Të gjitha rastet e raportuara tek platforma vijnë tek adresa zyrtare e email të ALO 116. Ekspertët e ALO 116 mbledhin, analizojnë dhe marrin masat për zgjidhjen, referimin apo raportimin e rasteve. Që nga publikimi i Platformës “[WWW.ISIGURT.AL](http://WWW.ISIGURT.AL)” në 9 Shkurt 2016 janë raportuar 76 raste të lidhura kryesisht me: ekspozimin ndaj imazheve apo materialeve me përmbajtje të paligjshme/papërshtatshme, Cyber bulling/mobile bulling, pornogarfii me të mitur në internet, sms dhe postime të tjera ofenduese, etj.

### Tabela paraqet të dhëna nga Platforma iSIGURT.al

Kategorizimi i rasteve	Numri i rasteve
Ekspozimi ndaj imazheve të paligjshme/të papërshtatshme	8
Cyber bulling/Bullizmi në internet	35
Pornogarfii me të mitur në internet	3
Sms dhe postime të tjera ofenduese	17
Vjedhje identiteti	13



**Grafiku paraqet të dhëna të raportuara pranë iSIGURT.al**

Duke iu referuar tabelës shohim që numri më i madh i raportimeve lidhet me cyber bullying ose mobile bullying. **Cyber-bulling** është një term i përdorur për të përcaktuar format e ndryshme të abuzimit psikologjik gjatë aktivitetit online të fëmijëve. Cyber bullying është terminologji që përdoret kur njerëzit përdorin internetin për të kërcënuar, ngacmuar, apo poshtëruar dikë duke dërguar mesazhe, fotografi dhe video. Janë 35 raste të raportuara të cyberbullying tek ISIGURT.AL. Më tipiket lidhen me tallje të përsëritur ndaj një personi duke përdorur nofka dhe epitete; dërgimin e mesazheve turpëruese nëpërmjet internetit, dërgimin e mesazheve elektronike me gjuhë vulgare, postimin dhe ndarjen e sekreteve, informacioneve të turpshme etj.

Në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë bullizmi nuk është i kriminalizuar dhe disa ekspertë mendojnë që kriminalizimi i bullying apo cyber bullying nuk do të përmirësojë situatën dhe nuk do të sjellë përfitime as për abuzuesin dhe as për fëmijën/adoleshentin e abuzuar. Ekspertë e vendosin theksin tek psikoedukimi dhe parandalimi i fenomenit të dhunës bashkëmoshtare qoftë kjo online ose offline. Këshilluesit e ALO 116 i janë nështruar një sërë trainimesh mbi çështjet e sigurisë online për të përforcuar rolin psikoedukues të saj dhe për të parandaluar fenomenin.



Dy raste i referohen pornografisë për të mitur. Këto dy raste pas raportimit në you tube janë bllokuar. Pornografia me të mitur është çështje shumë e ndjeshme dhe gjen mbështetje ligjore në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, neni 117 ku thuhet se: Prodhimi, shpërndarja, reklamimi, importimi, shitja e botimi i materialeve pornografike në ambientet e të miturve, përbëjnë kundërvajtje penale dhe dënohen me gjobë ose me burgim gjer në dy vjet. Përdorimi i të miturit për prodhimin e materialeve pornografike, si dhe shpërndarja ose publikimi i tyre në internet apo në forma të tjera, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet dhe me gjobë nga një milion deri në pesë milionë lekë.

Raportimi i rasteve në pjesën me të madhe është bërë nga vetë personat që janë dhunuar dhe janë bërë pjesë e videove apo materialeve të publikuara. Vetëm në 18 raste nga 76 raste në total raportimi është bërë nga persona të rritur të afërm apo familjarë të personave që janë dhunuar online. Pjesa më e madhe, rreth 85% e ofendimeve, sharjeve, postimeve fyese kanë ndodhur në rrjetet sociale si instagram, facebook, you tube, snap chat ejj, dhe vetëm 8 raste kanë ndodhur në website ose email.

ALO 116 ka bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Shtetit, Sektorin e Krimit Kibernetik, nëpërmjet të cilit ka mundësuar shkëmbimin e praktikave të mira të menaxhimit të rasteve të cyber bulling, vjedhjes së identitetit etj. Ndërkohë, eksperiencia e përditshme ka vënë në dukje hapësirat ligjore për të cilat duhet punuar dhe të cilat do të ndihmojnë në mirë menaxhimin e rasteve të fëmijëve të dhunuar në botën online. ALO 116 po punon dhe ka qënë pjesë aktive e diskutimeve për ndryshimet e mundshme në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë si dhe në Ligjin për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve Nr.10 347, datë 4.11.2010.

Referimi i rasteve të raportuara nëpërmjet Platformes iSIGURT.AL	Numri i rasteve
You tube/facebook/instagram	76
Sektorin e Krimit Kibernetik, Policia e Shtetit	14
ALCIRT	2
Agjensia Kombëtare e Mbrojtjes së Fëmijëve	6
ALO 116	76

## **8. ECURIA DHE REZULTATET E RASTEVE TË TRAJTUARA TEK PLATFORMA ISIGURT.AL PËR PERIUHDËN JANAR – GUSHT 2016**

Kategoria e parë e rasteve e lidhur me ekspozimin e fëmijëve ndaj imazheve të paligjshme/të papërshtatshme ka patur një ecuri të sukseshme dhe të 8 rastet janë raportuar dhe mbyllur në rrjetet sociale përkatëse. Fëmijët janë këshilluar në të gjitha rastet që të komunikojnë me ALO 116 dhe të marrin këshilla dhe udhëzime të detajuara.

14 prej rasteve janë raportuar tek Sektori i Krimit Kibernetik, Policia e Shtetit. Kryesisht rastet e raportuara këtu janë rastet e bullizmit dhe cyber bullizmit. Për këto raste është shkëmbyer informacion dhe janë takuar përfaqësues të prokurorisë dhe sektorit të krimit kibernetik tek Policia e Shtetit. Për shkak të vakumit ligjor asnjë nga rastet nuk ka kaluar në prokurori për tu gjykuar më tej në institucionet respektive.

Për konkluzion, e gjithë dosja e deritanishme e platformës ISIGURT.AL, është ndarë me Agjensinë për Sigurinë Kompjuterike - ALCIRT dhe Agjensinë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve - ASHMDF. Hapësirat aktuale ligjore nuk lejojnë që këto institucione të punojnë në drejtim të rasteve të raportuara tek platforma. Të gjitha institucionet më sipër po punojnë për përmirësimet e nevojshme ligjore në kodin Penal dhe jo vetëm, në mënyrë që të krijohet mundësia dhe hapësira për të menaxhuar rastet e sigursë së fëmijëve online.

## **9. RAST STUDIMOR NGA ALO 116 111**

### **Historiku i rastit**

F. një vajzë 13 vjeçare telefonon pranë Linjës së Këshillimit për Fëmijë për të shprehur shqetësimin e saj lidhur me problematikat që ka ndeshur gjatë qëndrimit online. Prej pak kohësh ka një llogari në rrjetin social instagram. Pretendon se dikush ka marrë fotot që ka postuar duke i berë “screen shoot” dhe më pas i ka postuar në një adresë false në instagram. Fotoja e saj është postuar e shoqëruar me një etiketim ofendues dhe fyes. Adresa false përmban emrin e një shoqe të ngushtë, e cila tregon se ajo faqe nuk është në përdorim të saj. F. shprehet se dikush po përdor një profil të rremë të një personi shumë të dashur për të, me qëllim për ta fyer dhe për të prishur reputacionin e saj me etiketimet ofenduese dhe turpëruese kundrejt vajzës. F. pohon se asnjëherë nuk ka pasur konflikt me

askënd dhe se kjo situatë e ka shqetësuar shumë. Ajo ndjehet keq dhe ndjehet e frikësuar se çfarë mund të ndodhë më pas. Tashmë llogaria në instagram është private dhe e mirëkontrolluar prej saj.

E shqetësuar dhe e revoltuar me abuzimin që po i bëhet, vajza dëshiron të bëjë diçka sa më shpejt që fotoja e saj të hiqet nga ky profil. Deri tani ka zgjedhur të mos e bisedojë me prindërit pasi është ndjerë në siklet për të komunikuar me ta për diçka të tillë.

### **Strategjitë e ndërhyrjes:**

F. telefonon tek Linja e Këshillimit për Fëmijë ALO 116 e tensionuar. Vajza shprehet me shumë vështirësi dhe perceptohet shumë frikë në zërin e saj. Këshilluesi fillimisht përpiqet të ndërtojë një urë komunikimi me të duke treguar gadishmëri dhe empati gjatë bisedës.

Diskutimi për ndjenjat morri një periudhë të konsiderueshme për të sjellë në ndërgjegjen e vajzës përballjen me përjetimet e saj emocionale. F. është sfiduar drejt mendimeve pozitive dhe drejt dëshirave dhe ëndrrave të saj për të ardhmen për të krijuar një koncept pozitiv për veten, për të rritur vetëvlerësimin e për të rritur motivimin e dëshirën për të qenë një person i angazhuar. Së bashku me këshilluesin, vajza diskuton mënyrat e privatësisë në rrjetet sociale. F. informohet në mënyrë të detajuar mbi rreziqet e lundrimit në internet dhe se si mund të jetë e sigurt online. Këshilluesi informon për mënyrat e raportimit online dhe procedurën që ndiqet. F. gjithashtu identifikoi se prindërit mund të jenë lehtësues duke e mbështetur dhe këshilluesi e inkurajon ta bëjë këtë hap për aq kohë që ajo mendon se do të ndihet më mirë nëse ata do të ishin pranë saj për ta ndihmuar. Duke e falenderuar, vajza ftohet të telefonojë sërish.<sup>15</sup>

---

<sup>15</sup> Rast i raportuar pranë ALO 116 111

## 10. GJETJET E RAPORTIT

- ✚ Legjislatiioni për mbrojtjen e femijëve nga abuzimi dhe shfrytëzimi në internet është i mangët. Bazuar në të gjitha raportimet tek platforma isigurt.al vihet re që si Kodi Penal dhe ligji për Mbrojtjen e të Drejtave të Femijëve nuk garantojnë mbrojtje të femijë nga rreziqet në internet.
- ✚ Grupmosha që raporton më shpesh për çështje të sigurisë online është ajo 13-15 vjeçare dhe në raport me vajzat, djemtë janë më të shumtë në numër.
- ✚ Raportimi i rasteve në pjesën me të madhe është bërë nga vetë femijët që janë përballur me problematika gjatë qëndrimit online.
- ✚ Përgjithësisht femijët zgjedhin të përdorin aparatët e tyre personale (telefona celularë apo tabletë), për t'iu shmangur kontrollit prindëror dhe për të aksesuar faqe me përmbajtje të papërshtatshme.
- ✚ Femijët të cilët raportojnë problematika në çështjet online shpesh herë përjetojnë ndjenja vetmie dhe kërkojnë vazhdimisht vëmendje duke qënë se ndjehen të neglizhuar dhe “të lënë pas dore”. Për këtë arsye zgjedhin rrjetet sociale si mënyrën më të mirë për të plotësuar mungesat që ndjejnë.
- ✚ Femijët tashmë janë të mirë informuar mbi rreziqet e mundshme online, por megjithatë duket se një pjesë e tyre mendon se e kanë nën kontroll situatën dhe si rrjedhojë nuk i kushtojnë shumë rëndësi detajeve të cilat mund ti sjellin problematika gjatë lundrimit online.
- ✚ Një pjesë e konsiderueshme e femijëve të cilët raportojnë problematika gjatë lundrimit në internet, tregojnë që prindërit e tyre janë më pak të informuar se ata mbi çështje të sigurisë online dhe mbi përdorimin e internetit.
- ✚ ALO 116 ka bashkëpunuar ngushtë me Policinë e Shtetit, Sektorin e Krimit Kibernetik, nëpërmjet të cilit ka mundësuar shkëmbimin e praktikave të mira të menaxhimt të rasteve të cyber bulling, vjedhjes së identitetit etj.

- ✚ Nuk ka një procedurë standaret të trajtimit të rasteve të sigurisë online nga ana e institucioneve shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, kjo edhe për shkak të boshllëqeve në legjislacionin aktual.
- ✚ Mungesa e hapësirave ligjore për të trajtuar rastet e bullizmit, cyber bullizmit, vjedhjes së identitetit në internet etj, në institucionet ekzekutive.

## 11.REKOMANDIME

- ✚ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë të amendohet sa më shpejt të jetë e mundur në mënyrë që të përfshijë të gjitha këto vepra penale që cenojnë sigurinë e fëmijëve në internet.
- ✚ Bashkimi Europian ka rekomanduar përmirësimin e të gjithë legjislacionit në fushën e fëmijëve. Ligji i ri i të Drejtave të Fëmijëve duhet të përfshijë procedura specifike për mbrojtjen e fëmijëve gjatë lundrimit në internet dhe çfarë masash duhet të merren nga Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe Policia për të mbrojtur fëmijët nga rreziqet në internet.
- ✚ Rekomandohet që fëmijët të jenë shumë të kujdesshëm në përdorimin e internetit dhe të mendojnë gjatë para se të postojnë diçka online, qofshin këto fotografi, materiale të ndryshme apo edhe të dhëna personale. Kur diçka postohet online mund të jetë prezente në internet për një kohë të gjatë dhe persona të tjerë mund ta përdorin për qëllime të ndryshme.
- ✚ Prindërit dhe fëmijët duhet të tregohen të kujdesshëm përpara se të përdorin të dhënat e tyre personale gjatë përdorimit të internetit. Dikush mund t'i përdorë këto të dhëna për të shkaktuar dëme tek familja.
- ✚ Fëmijët duhet të tregojnë kujdes në pranimin e kërkesave që vijnë nga persona të panjohur apo kur këto kërkesa kanë përmbajtje të papërshtatshme apo të pakëndëshme.
- ✚ Rekomandohet që prindërit të mundësojnë për fëmijët e tyre programe dhe filtra sigurie për faqet të cilat nuk duhet të vizitohen nga fëmijët dhe të mbrojnë kështu ata nga ekspozimi ndaj materialeve të pëpërshtatshme apo të paligjshme.

- ✚ Prindërit dhe fëmijët rekomandohen të bashëveprojnë me njëri tjetrin për të gjetur burime të sigurta nga të cilat të mund të marrin informacion të saktë dhe të sigurt.
- ✚ Duhet të tregohet kujdes me lojrat online. Rekomandohen të përdoren pseudonime gjatë lojës dhe të mos tregohen të dhënat personale. Nëse lojrat janë të pasigurta rekomandohet të bisedohet me prindërit ose me personat më të rritur të besueshëm për fëmijët.
- ✚ Nëse merrni mesazhe online ofenduese ose kërcënuese, rekomandohet që ato të ruhen dhe të mos u kthehet asnjë përgjigje.
- ✚ Telefononi ALO 116111 për problematikat me të cilat përballeni gjatë lundrimit në internet ose konsultohuni me platformën [ISIGURT.al](http://ISIGURT.al) për informacione të ndryshme dhe për të raportuar raste konkrete.
- ✚ Rekomandohet zbatimi i një procedure standarte nga institucionet shtetërore përgjegjëse për mbrojtjen e fëmijëve, për ndjekjen, raportimin dhe trajtimin e rasteve të shfrytëzimit dhe abuzimit online;
- ✚ Nevojiten ndryshime ligjore të lidhura me: mbrojtjen e fëmijës nga bullizmi dhe cyber bullizmi; mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi që mund ti bëhet në botën virtuale; mbrojtjen e fëmijëve nga manipulimi në internet për qëllime seksuale apo nga shtytja që mund ti bëhet për të hyrë në marrëdhënie seksuale;
- ✚ Nevojitet mbështetje ligjore për ruajtjen e identitetit të fëmijëve edhe në botën virtuale;
- ✚ Promovimi i Platformave Kombëtare të Informimit dhe raportimit mbi sigurinë e fëmijëve në internet dhe shërbimeve kombëtare sic mund të jenë: [ISIGURT.AL](http://ISIGURT.AL), ALO 116 etj.



**LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI**  
Albanian National Child Helpline (ANCH)

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;  
Tel / Fax: + 355 4 2265741  
E-mail: [alo116@crca.al](mailto:alo116@crca.al) [www.alo116.al](http://www.alo116.al)



## REFERENCAT

Instituti Shqiptar i Medias, “Fëmijët dhe Media”, Dhjetor 2011  
<http://www.institutemedia.org/Documents/PDF/femijet%20dhe%20media%20shqip%20per%20shtyp.pdf>

World Vision , “A Study on Child Online Safety in Albania”, 2014.  
<http://www.wvi.org/sites/default/files/Internet%20Safety%20OK.pdf>

The Impact of Social Media on Children, Adolescents, and Families, American Academy of Pediatrics. Clinical Report  
<http://pediatrics.aappublications.org/content/127/4/800>

Internet World Statistics, Internet Usage Statistics, June 2016.  
<http://www.internetworldstats.com/stats.htm>

ITU - International Telecommunication Union, ICT Facts and Figures, 2016.  
<http://www.itu.int/en/ITU-D/Statistics/Documents/facts/ICTFactsFigures2016.pdf>

Cyberbullying Research Centre, What is Cyberbullying.  
<http://cyberbullying.org/what-is-cyberbullying>

South West Grid for Learning and UK Safer Internet Centre “So you got naked online!”  
<http://www.saferinternet.org.uk/sites/default/files/Resources/So%20you%20got%20naked%20online.pdf>

ECPAT International, SECO, Child Sexual Abuse Material or Child Pornography.  
[http://www.ecpat.org/wp-content/uploads/legacy/SECO%20Manifestations\\_CSAM.pdf](http://www.ecpat.org/wp-content/uploads/legacy/SECO%20Manifestations_CSAM.pdf)

ECPAT International, SECO, Grooming Manifestations Factsheet.  
[http://www.ecpat.org/wp-content/uploads/legacy/SECO%20Manifestations\\_Grooming.pdf](http://www.ecpat.org/wp-content/uploads/legacy/SECO%20Manifestations_Grooming.pdf)

[https://sq.wikipedia.org/wiki/Virusi\\_i\\_kompjuterit](https://sq.wikipedia.org/wiki/Virusi_i_kompjuterit)

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Spam>



**LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI**  
Albanian National Child Helpline (ANCH)

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;  
Tel / Fax: + 355 4 2265741  
E-mail: [alo116@crca.al](mailto:alo116@crca.al) [www.alo116.al](http://www.alo116.al)



**ALO 116-Linja Kombëtare e Këshillimit për Fëmijë është një shërbim pa pagesë për fëmijët 24/24 çdo ditë të javës I cili ofron:**

- Dëgjim aktiv të fëmijëve
- Këshillim psikologjik
- Informacion për të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve
- Referim në shërbimet përkatëse sipas specifikës së rastit.

Ky shërbim përqëndrohet tek fëmijët në nevojë si: fëmijët e dhunuar, abuzuar apo keqtrajtuar, fëmijët e rrugës, fëmijët që shfrytëzohen në punë, fëmijët që janë në konflikt me ligjin etj. Ky shërbim nuk përjashton as prindërit, mësuesit, edukatorët apo personat që punojnë me fëmijët dhe personat e intersuar për çështje lidhur me dhe për fëmijët.

Me 19 tetor 2012, ALO 116 u bë anëtare me të drejta të plota e Linjës Ndërkombëtare të Këshillimit për Fëmijë (CHI ) si një mundësi për të sjellë zërin e fëmijëve shqiptarë sëbashku me zërin e fëmijëve nga Europa dhe bota.





**LINJA KOMBËTARE E TELEFONIT PËR FËMIJËT NË SHQIPËRI**  
Albanian National Child Helpline (ANCH)

Mail address: P. O. Box 1738, Tirana / Albania;  
Tel / Fax: + 355 4 2265741  
E-mail: [alo116@crca.al](mailto:alo116@crca.al)      [www.alo116.al](http://www.alo116.al)



ALO 116 mbështetet dhe financohet nga :



dhe të gjitha kompanitë e telefonisë në Shqipëri:

